



C.nr.4/15

GJKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike të paditëses [redacted] Prishtinë, të cilën e përfaqëson [redacted] me autorizim, kundër të paditurit [redacted], nga Ferizaj Rr. [redacted] për pagimin e borxhit, vlera e kontestit 1,614,57 €, pas seancës publike të mbajtur më 24.12.2015, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses dhe në mungesë të paditurit mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesë padia e paditëses, [redacted] Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurit [redacted] nga Ferizaj Rr. [redacted] si e bazuar pjesërisht

II. DETYROHET i padituri, që paditëses t'i paguajnë shumën prej 1,334.87 €, në emër të borxhit të cilin borxh e kanë krijuar me rastin e marrjes së kredisë.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditëses mbi lartësitë e shumës të aprovuara në pikën një (I dhe II) të dispozitivit

IV. DETYROHET i padituri që paditëses të i paguaj shumat e cekura në pikën I dhe II të dispozitivit, në shumë të përgjithshme prej 1.334.87 € (njëmijë e treqind etridhjetë e kate euro e tetëdhjetë e shtatë cent), si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 40 €, të gjitha në afat prej 15 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Përfaqësuesi i paditëses në fjalën e tij ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë si dhe precizimit të kërkesë padisë duke shtuar se nga provat e administruara u vërtetua se i padituri ia ka borxh paditës shumën e precizuar, ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesë padinë ta aprovon si të bazuar.

I Ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestuese.

Nga fletkthesa e ardhur shihet se ftesa të pranuarit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt, mungesën nuk e kanë arsyetuar dhe shtyrjen nuk e ka kërkuar andaj gjykata seancën e ka mbajtur në mungesë të paditurit, në kuptim të 423.4 të LPK-së.

Gjykata në këtë çështje bëri administrimin e provave duke bërë leximin e tyre: U lexua padia e paditëses C.nr.4/15 e dt.05.01,2015, marrëveshja kreditore me nr.1959/1/Fe

e dt.22.12.2011, e lidhur në mes paditësit dhe të paditurit, autorizimi me nr.1999/4/Fe e dt.22.12.2011, autorizimi i paditëses dhënë përfaqësuesit [REDACTED] pasqyra e obligimeve të dt.24.12.2015.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është e bazuar pjesërisht ashtu siç është aprovuar në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga provat e administruara u vërtetua se të paditurit kanë lidhur kontratë për marrjen e kredisë me paditësen në shumë prej 2.500€, të cilën shumë pjesërisht e kanë paguar kurse kanë mbetur pa paguar shumën prej 1,334,87€ siq shihet nga pasqyra e obligimeve w st.24.12.2015, e cila vërtetohet me faktin se të paditurit me paditësen janë në raport juridiko-civil ndërmjet vete sipas nenit 26 LMD-së dhe nga ky raport janë krijuar të drejtat dhe detyrimet në kuptim të nenit 148 lidhur me nenin 1065 të LMD-së, i cili fakt vërtetohet nga provat e administruara kontrata e kredisë.


Gjykata ka refuzuar kamat vonesën e kërkuar nga ana e paditëses në shumë prej 238,49€, duke marr për bazë se një kamat e tillë është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 56 të LMD-së meqenëse paditësja e ka shfrytëzuar vartësinë e të paditurit ku ia ka kontraktuar edhe kamatë vonesën prej 3%, mujore siq është e përcaktuar me nenin 4 pika 2 e kontratës së kredisë

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së në të cilat shpenzime është llogaritur taksa gjyqësore për padi prej, 20 € dhe aktgjykim prej, 20 €, gjithsej në lartësi prej 40 €.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.4/15 më dt.24.12.2015



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj Gjykate.

